

Titulli i lëndës: LETËRSIA E KRAHASUAR

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Letërsia e krahasuar
Niveli:	MA
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i pestë Semestri i nëntë
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa 74
Mësimdhënësi:	Prof. dr. Osman Gashi
Të dhënat kontaktuese:	+383 44 174 174 // osman.gashi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p><i>Ky kurs është paraparë që t'i përgatisë studentët e Departamentit të Letërsisë Shqipe që kanë kryer studimet e shkallës Bachelor, për punë hulumtuese – shkencore në një fushë specifike të studimeve letrare. Do të shpjegojë konceptet dhe zhvillimet teorike krahasimtare, të cilat zbatohen përmes vizioneve fleksibile mbi funksionet e teksteve letrare si dhe të mesazheve letrare artistike.</i></p> <p><i>Metodologjia letrare krahasimtare ofron njohuri specifike të metodologjisë së përgjithshme letrare, për instrumentet dhe nocionet teoriko – letrare siç janë: influencat, interaksionet letrare, relacionet, plagjiarizmi, burimet e letërsisë, gjeneza e zhanreve letrare, intertekstualiteti, përkthimet, receptimi, lexuesi dhe të lexuarit, kontaktet letrare etj.</i></p> <p><i>Të gjithë këta konstituentë të Letërsisë së krahasuar do të zhvillohen në një proces interaktiv dhe praktik, ku do të përfshihen shembuj të letërsive të veçanta dhe përfaqësuesit kryesorë të tyre.</i></p> <p><i>Ky modul (kurs) i conceptualizon nocionet, idetë dhe definicionet siç janë: <u>Letërsi botërore</u> dhe <u>Letërsi nacionale</u> si dhe interaksionet midis tyre, nga njëra anë dhe vlerat universale letrare të të gjitha kohëve, nga ana tjetër.</i></p> <p><i>Studimi i letërsisë së krahasuar është ngushtë i lidhur edhe me hulumtimet interdisiplinare për fushat tjera të dijes si: filmi, muzika, teatri etj.</i></p>

Qëllimet e lëndës:	Qëllimi themelor i kursit është që të njohë studentët me konceptet dhe postulatet themelore të disiplinës së Komparatistikës si dhe me zhvillimet aktuale të saj te ne dhe në botë. Gjithashtu do të bëhet përpjekje që studentët individualisht apo në grupe të hulumtojnë vetë dukuri, vepra e autorë të letërsisë shqipe e botërore në kontekstin krahasimtar.
--------------------	---

Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Gjatë zhvillimit të ligjëratave, ushtrimeve e konsultimeve si dhe në përfundim të kursit studentët do të kenë mundësinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Të fitojnë informacione dhe të demonstrojnë njohuri për letërsinë e shkruar në vende të ndryshme e në periudha të ndryshme historiko – letrare; ○ Të tregojnë aftësi për lexime kritike si dhe për shkrime kritike – analitike e krahasim-tare; ○ Të përdorin me saktësi literaturën shkencore teoriko – letrare e historiko – letrare;
-----------------------------------	---

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime kollokuiume, teste, punë në grupe, shkrime esesh
-------------------------	--

Metodat e vlerësimit:	<p>Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50 %.</p> <p>Vijueshmëria e studentit 10 %;</p> <p>Detyrat individuale të kryera në klasë 10 %;</p> <p>Detyrat individuale të kryera në shtëpi 10 %;</p> <p>Vlerësimi nga testet 20 %;</p> <p>Provimi final 50 %.</p>
-----------------------	---

Veprat letrare:	Homeri: <i>Iliada</i> – Gj. Fishta: <i>Lahuta e Malcis</i> ; Eskili: <i>Orestia</i> – Shekspiri: <i>Hamleti</i> ; Dante Aligieri: <i>Komedia hyjnore</i> – Servantesi: <i>Don Kishoti i Mançës</i> ; Stendal: <i>E kuqja dhe e zeza</i> – Tolstoj: <i>Ana Karenina</i> ; De Rada: <i>Këngët e Milosaos</i> – Pushkini: <i>Eugjen Oniegin</i> ; Homer: <i>Odiseja</i>
-----------------	--

Literatura shkencore:	<p><u>Literatura primare</u></p> <p>Yves Chevrel: Letërsi e krahasuar, Tiranë 2002; Rene Velek e Ostin Uoren: Teoria e letërsisë, Tiranë, 2007; Umberto Eco: Për letërsinë, Tiranë 2007; Osman Gashi: Letërsia dhe Miti (studime krahasimtare), Prishtinë, 2014; Erich Fromm: <i>Gjuha e harruar</i>, Tiranë, 1998; Nathalie Piegay – Gros: Poetika e intertekstualitetit, Prishtinë.</p> <p><u>Literatura sekondare</u></p> <p>Northrop Fraj: <i>Anatomia e kritikës</i>; Thomas Sterns Eliot: Ese të zgjedhura, Prishtinë, 1982; Benedetto Croce: <i>Poezia antike dhe moderne</i>, Tiranë, 1998; David Lodge: <i>20th Century Literary Criticism</i>,</p>
-----------------------	--

	<i>London & New York, 1994; Claudio Guillen: "The Challenge of Comparative literature", Harvard University Press, 1993;</i>
Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Letërsia kombëtare, Letërsia botërore dhe Letërsia e përgjithshme – konceptet, objekti I studimit
Java 2:	Letërsia e krahasuar – postulatet themelore, bazat teorike dhe historia; Letërsia në kontekst
Java 3:	Folklori dhe mitologjia
	Letërsia Perëndimore deri në Renesancë
Java 4:	Letërsia Perëndimore pas Renesancës
Java 5:	Morfologjia letrare (gjinitë, zhanret e format letrare – perspektiva globale)
Java 6	Shkollat e Komparatistikës a/ Shkolla franceze b/ Shkolla amerikane
Java 7:	Shkëmbimet letrare ndërkombëtare
Java 8:	Periodizimi ndërkombëtar i letërsisë – periudhat letrare; brezat (gjeneratat)
Java 9:	Rrafshet e interliteraritetit (vështrim i përgjithshëm)
Java 10:	Idetë letrare (vështrim i përgjithshëm)
Java 11:	Idetë religjioze dhe idetë filozofike
Java 12:	Idetë shkencore dhe idetë politike
Java 13:	Reminishencat, huazimet letrare dhe ndikimet
Java 14:	Kongruencat, Filiacioni, lidhjet etnike, regjionale, gjuhësore
Java 15:	Ndërmjetësit letrarë – përkthyesit dhe përkthimet letrare; Imagologjia; Koloriti lokal; Temat periodike

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet e tjera, siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet, janë të ndaluara.